

VENDIM
Nr.337, datë 1.6.2004

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 23.6.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

Në pikën 1 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë pas fjalëve “...për prokurimin e shërbimeve...” të hiqet fjalia në vazhdim:

“...me përjashtim të projekteve, ku si referim të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.”.

b) Në paragrafin e dytë shifra “... mbi 300 000 000 (treqind milionë) lekë” zëvendësohet me “... mbi 200 000 00 (dyqind milionë) lekë, duke filluar nga data 1 janar 2005.”.

2. Në pikën 2 pas fjalëve “...për prokurimin e shërbimeve...” të hiqet fjalia në vazhdim:

“...me përjashtim të projekteve, ku si referim të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 4 fjalët “Pika 1/b/c/ç...” të zëvendësohen me “Pikat 1/b/c...”.

4. Në pikën 6 pas fjalëve “...sigurimit të ofertave...” të hiqen fjalët “..., në formë garancie bankare...”.

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Pjesëmarrësi në tender, i shpallur fitues, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit duhet t’i konfirmojë entit prokurues, nëpërmjet nënshkrimit të formularit të kontratës, gatishmërinë për të lidhur kontratën.

Në rast se brenda këtij afati, përgjigjja nga pjesëmarrësi fitues është negative, entit prokurues i lind e drejta të njoftojë për negociimin e kontratës pjesëmarrësin e renditur të dytin në klasifikim, sipas pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të bëjë njëkohësisht konfiskimin e sigurimit të ofertës së pjesëmarrësit të parë fitues.”.

6. Në pikën 10 afati “...jo më vonë se 10 ditë përpara shpalljes së saj.” ndryshohet me “...jo më vonë se 5 ditë përpara shpalljes së saj.”, dhe në fund të kësaj pike shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, për tenderat që botohen në Buletin e Prokurimit Publik, enti prokurues është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga shpallja e njoftimit në buletin të fituesit të tenderit, të lidhë kontratën.”.

7. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Entet prokuruese, brenda datës 15 shkurt, të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrat e parashikimeve të prokurimeve publike, sipas udhëzimeve të kësaj agjencie, si dhe ndryshimet e planit të prokurimeve publike gjatë vitit kalendarik. Entet prokuruese, në fund të çdo 4 mujori, brenda datës 20 të muajit pasardhës, të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik treguesin për realizimin apo jo të prokurimeve të planifikuara, të shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimeve të kësaj agjencie. Për realizimin e kësaj detyre, titullari i entit prokurues ngarkon njësinë e prokurimit (nëse ka) apo strukturën përgjegjëse, që planifikon fondet e prokurimeve. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda datës 30 të po atij muaji, të paraqesë në Këshillin e Ministrave pasqyrën përmbledhëse të prokurimeve në shkallë vendi.”.

8. Shkronja “a” e pikës 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Në entin prokurues brenda 5 (pesë) ditëve pas marrjes me shkrim të njoftimit të klasifikimit përfundimtar të ofertave.”.

9. Në fund të pikës 13 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Vazhdimi i mëtejshëm i procedurës së prokurimit nga enti prokurues bëhet pas miratimit të këtij raporti nga Agjencia e Prokurimit Publik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano